

Legjenda për lejat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. 687 Prot.

Tiranë, më 6.2 2006

URDHËR

NR. 56 datë 6.2 2006

MBI

PROCEDURAT E DHËNIES SË LEJEVE TEKNIKO - TEKNOLOGJIKE DHE
PROFESIONALE PËR PRODHIMIN E PRODUKTEVE USHQIMORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit nr.7941 datë 31.05.1995 "Për ushqimin", Kreu I, neni 8 dhe 11

URDHËROJ:

1. Për marrjen e lejes tekniko - teknologjike dhe/ose lejes profesionale subjekti paraqet kërkesën me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit ku ushtron aktivitetin. Kërkesa përpilohet në përputhje me këtë Urdhër dhe rregulloren nr.1 datë 09.03.1998 "Mbi kërkesat tekniko - teknologjike që duhet të plotësojnë objektet ushqimore" si dhe rregullore të veçanta për fusha të ndryshme të prodhimit ushqimor.
2. Leja tekniko - teknologjike jepet pasi të jetë kryer vlerësimi i dokumentacionit dhe të jetë bërë inspektimi i aktivitetit që do të zhvillohet sipas këtij Udhëzimi dhe rregullores nr. 1 datë 09.03.1998 "Mbi kërkesat tekniko-teknologjike që duhet të plotësojnë objektet ushqimore" si dhe rregulloreve për fusha të veçanta të prodhimit ushqimor.
3. Subjekti i interesuar për pajisjen me lejen tekniko - teknologjike paraqet të dhënat e mëposhtme për aktivitetin që kryen:
 - a) emri dhe adresa ku zhvillohet aktiviteti
 - b) përshkrimi i lokalit (mjediset kryesore dhe ndihmëse)
 - c) pajisjet e instaluara
 - d) proceset teknologjike dhe kapacitetet e prodhimit
 - e) lëndët e para dhe ndihmëse dhe karakteristikat themelore të tyre
 - f) produktet e gatshme dhe karakteristikat kryesore të tyre
 - g) amballazhimi dhe etiketimi i produktit të gatshëm

- h) kushtet e ruajtjes së lendeve të para dhe produktit të gatshëm
- i) grumbullimi dhe largimi i mbeturinave
- j) krijimi dhe largimi i mbetjeve teknologjike të krijuara
- k) të dhëna të tjera për rastet e prodhimeve të veçanta

4. Leja tekniko - teknologjike jepet pasi paraprakisht subjekti i interesuar, në varësi të aktivitetit që do të kryej dhe teknologjisë që do të përdorë, të ketë marrë lejen higjeno-sanitare, sanitaro-veterinare, të mbrojtjes nga zjarri, të mbrojtjes së mjedisit, të përdorimit të pajisjeve nënpresion etj. Të gjitha këto leje paraqiten sëbashku me kërkesën dhe të dhënat për kryerjen e aktivitetit.

5. Subjekti prodhues apo ambalazhues që pajiset me lejet tekniko - teknologjike dhe/ose profesionale paguan pranë Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit tarifën e përcaktuar në legjislacioni përkatës.

6. Për marrjen e lejes profesionale subjekti i interesuar punëson specialistë vendas apo të huaj që kanë të paktën një nga shkallët e arsimimit apo kualifikimeve të mëposhtme:

- a) arsim i lartë në degën kimi ose teknologji ushqimore: /
- b) arsim i mesëm profesional ushqimor:
- c) shkallën e mesme të atestimit në fushën e ushqimit:
- d) kurse specializimi pranë Institutit të Kërkimeve të Ushqimit sipas një programi të veçantë: /
- e) dëshmi specializimi brenda ose jashtë vendit në fushën e teknologjisë ushqimore.

Specialisti që pajiset me lejen profesionale duhet të ketë ushtruar këtë profesion për një periudhë jo më pak se një vit dhe mban përgjegjësi për aktivitetin ku punon sipas legjislacionit në fuqi.

Subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm për specialistin/specialistët e angazhuar në procesin e prodhimit:

- a) dokumenti identifikimit të personit
- b) dokumenti zyrtarë që vërteton profesionin (diplomë, dëshmi etj.)
- c) raport mjekësor për aftësinë në punë
- d) kontrata e punës mbi angazhimin e specialistit/specialistëve me subjektin prodhues.

— 7. Në rastin e ndryshimit të specialistit ushqimor, në bazë të të cilit është siguruar leja profesionale, subjekti njofton pranë Inspektoriatit të Sigurisë Ushqimore dhe fillon procedurat për pajisjen me lejen profesionale të specialistit të ri.

8. Lejet tekniko - teknologjike dhe profesionale për prodhimin e produkteve ushqimore jepen në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit ku zhvillohet aktiviteti. Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit ngre një komision, i cili përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë. Anëtarët e këtij Komisioni janë specialistë të Inspektoriatit të Sigurisë Ushqimore dhe specialistë të agroperpunimit në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit. Kryetar i Komisionit është përgjegjësi i Inspektoriatit të Sigurisë Ushqimore. Kur është e nevojshme Komisioni thërret ekspertë të jashtëm të fushës së ushqimit. Mbi bazën e vlerësimit të këtij Komisioni, drejtori i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit jep lejet tekniko - teknologjike dhe profesionale.

- h) kushtet e ruajtjes së lendeve të para dhe produktit të gatshëm
- i) grumbullimi dhe largimi i mbeturinave
- j) krijimi dhe largimi i mbetjeve teknologjike të krijuara
- k) të dhëna të tjera për rastet e prodhimeve të veçanta

4. Leja tekniko - teknologjike jepet pasi paraprakisht subjekti i interesuar, në varësi të aktivitetit që do të kryej dhe teknologjisë që do të përdorë, të ketë marrë lejen higjeno-sanitare, sanitaro-veterinare, të mbrojtjes nga zjarri, të mbrojtjes së mjedisit, të përdorimit të pajisjeve nënpresion etj. Të gjitha këto leje paraqiten sëbashku me kërkesën dhe të dhënat për kryerjen e aktivitetit.

5. Subjekti prodhues apo amballazhues që pajiset me lejet tekniko - teknologjike dhe/ose profesionale pagan pranë Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit tarifën e përcaktuar në legjislacioni përkatës.

6. Për marrjen e lejes profesionale subjekti i interesuar punëson specialistë vendas apo të huaj që kanë të paktën një nga shkallët e arsimit apo kualifikimeve të mëposhtme:

- a) arsim i lartë në degën kimi ose teknologji ushqimore : /
- b) arsim i mesëm profesional ushqimor :
- c) shkallën e mesme të atestimit në fushën e ushqimit.
- d) kurse specializimi pranë Institutit të Kërkimeve të Ushqimit sipas një programi të veçantë: /
- e) dëshmi specializimi brenda ose jashtë vendit në fushën e teknologjisë ushqimore.

Specialisti që pajiset me lejen profesionale duhet të ketë ushtruar këtë profesion për një periudhë jo më pak se një vit dhe mban përgjegjësi për aktivitetin ku punon sipas legjislacionit në fuqi.

Subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm për specialistin/specialistët e angazhuar në procesin e prodhimit:

- a) dokumenti identifikimit të personit
- b) dokumenti zyrtarë që vërteton profesionin (diplomë, dëshmi etj.)
- c) raport mjeksor për aftësinë në punë
- d) kontrata e punës mbi angazhimin e specialistit/specialistëve me subjektin prodhues.

7. Në rastin e ndryshimit të specialistit ushqimor, në bazë të të cilit është siguruar leja profesionale, subjekti njofton pranë Inspektoriatit të Sigurisë Ushqimore dhe fillon procedurat për pajisjen me lejen profesionale të specialistit të ri.

8. Lejet tekniko - teknologjike dhe profesionale për prodhimin e produkteve ushqimore jepen në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit ku zhvillohet aktiviteti. Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit ngre një komision, i cili përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë. Anëtarët e këtij Komisioni janë specialistë të Inspektoriatit të Sigurisë Ushqimore dhe specialistë të agroperpunimit në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit. Kryetar i Komisionit është përgjegjësi i Inspektoriatit të Sigurisë Ushqimore. Kur është e nevojshme Komisioni thërret ekspertë të jashtëm të fushës së ushqimit. Mbi bazën e vlerësimit të këtij Komisioni, drejtori i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit jep lejet tekniko - teknologjike dhe profesionale.

9. Leja tekniko - teknologjike përsëritet çdo vit. Tarifa për përsëritjen e lejes tekniko - teknologjike, e cila paguhet pranë Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit, përcaktohet në legjislacioni përkatës.

10. Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit merr të gjitha masat për arshivimin e dokumentacionit të subjektit që pajiset me lejet tekniko- teknologjike dhe profesionale sipas legjislacionit në fuqi. Dokumentacioni duhet të jetë i plotë dhe i firmosur nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

11. Në rastet e rikonstruksionit të objektit ku zhvillohet aktiviteti prodhues, i cili shoqërohet me ndryshime të rëndësishme në krahasim me ato të mëparshme, subjekti duhet të pajiset me lejet përkatëse sipas kushteve të reja të zhvillimit të aktivitetit.

12. Subjekti i interesuar pajiset me lejet tekniko - teknologjike dhe profesionale brënda 30 diteve nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm.

13. Formulari "tip" i lejeve tekniko - teknologjike dhe profesionale miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

14. Urdhëri nr. 139 datë 08.04.1998 "Për lejet tekniko-teknologjike dhe profesionale për prodhimin e produkteve ushqimore" shfuqizohet.

15. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Inspektoriatet e Sigurisë Ushqimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

JEMIN GJANA

